



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Ilir Pendavinji, Klodiana Spahiu, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Nuri Belba Floida Kërpaçi dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Bardh Spahia, Vangjel Tavo, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

Të ftuar:

Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore

Blerta Cani - Drejtore Ekzekutive (Folëse), përfaqësuese e Fondacionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ADRF

Oltiana Andrea – Avokate (Folëse), Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci

Iris Aliaj – avokate, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Irena Shtraza - Menaxhere Programi, përfaqësuese e AWEN

Altin Hazizaj - Rrjeti Kombëtar “Vepro për Fëmijët” dhe CRCA Shqipëri

Blerta Balilaj Brovina – drejtore, Rrjeti i Demokracisë së Grave Shqipëria (WDN-Albania)

Robert Gajda - Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Merita Xhafaj - drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes
Sociale

Brundilda Dervishaj - specialiste në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Përshëndetje!

Sot në kalendarin e mbledhjes së komisionit është përcaktuar një seancë dëgjimore me të gjithë aktorët e interesuar, në mënyrë të veçantë për çështjet që lidhet me dhunën familjare, që janë objekt i ndryshimit të ligjit që kemi në shqyrtim si komision për dhënie mendimi. Në këtë dëgjese kanë shprehur interes për të marrë pjesë një numër i rëndësishëm i përfaqësuesve të shoqërisë civile që operojnë në këtë fushë. Radha nuk është preferenciale, por është një radhë të cilën mund ta quajmë të rastësishme, prandaj nuk dua të ofendohet njeri jo na radhitët të parët, jo të fundit, prandaj dua të çlirohem që në fillim nga ky lloj paragjykimi.

Në mbledhjen e sotme kemi përfaqësues nga Fondacioni i Personave me Aftësi të Kufizuara, konkretisht zonja Blerta Cani, drejtore ekzekutive, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, përfaqësuar nga Oltiana Andrea, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, e përfaqësuar nga Iris Aliaj, Qendra AWEN, përfaqësuar nga Irena Shtraza. Më tej të pranishëm kemi Rrjetin Kombëtar “Vepro për Fëmijët” dhe CRCA Shqipëri, përfaqësuar nga zoti Altin Hazizaj. “Alo 116” në Shqipëri, përfaqësuar nga Mirgit Vataj, Rrjeti i Demokracisë së Grave Shqipëria, përfaqësuar nga Blerta Brovina, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zoti Robert Gajdaj, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, përkatësisht zonja Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme dhe zonja Brunilda Dervishaj.

Kjo është lista që më është konfirmuar nga stafi dhe në qoftë se ka ndonjë që nuk e kam përmendur të më thotë për ta evidentuar nëse do të marrë fjalën.

Së dyti, desha të evidentoja para se të fillojmë dëgjesën, pse jo edhe të falënderoja mjaft nga aktorët nga shoqërisë civile, praktikisht Rrjetin e Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, Shoqatën AWEN, “Vepro për Fëmijët”, Komisionierin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, ku aktorët kanë paraqitur vërejtje dhe komente për përmirësimin e draftit që do të merret në shqyrtim nga komisioni.

Ju falënderoj me shumë mirënjohje, sepse është një kontribut i drejtpërdrejtë pikërisht për t'i shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të kualitetit të ligjeve që ne miratojnë, si dhe një punë e madhe dhe impenjim nga ana e të gjithë aktorëve, të cilët meritojnë vetëm të lëvdohen për gjithçka!

Për sa i takon Komitetit të Helsinkit, vërejtjet janë dërguar, por ata nuk janë të pranishëm sot për zgjedhjen e tyre, pasi ne njoftimin e kemi bërë edhe për ta, por mirënjohja është edhe për ta dhe komentet e dërguara, të cilat disponohen nga komisioni dhe janë vënë në dispozicion edhe

të grupit që do të merret me përmirësimet eventuale të atyre vërejtjeve që do të gjykohen të nevojshme për t'u reflektuar.

Pa humbur kohë, meqenëse pjesëmarrësit janë të shumtë, një pjesë e tyre janë miq të përhershëm të komisionit tonë dhe besoj se kjo është një risi pozitive, pasi kjo lloj marrëdhënie duhet të vazhdojë të zhvillohet, të thellohet, por njëkohësisht puna jonë dhe realiteti janë më afër njëri-tjetrit, sepse vektorë më të drejtpërdrejtë se përfaqësuesit e shoqërisë civile nuk mund të ketë.

Ashtu sikurse kemi operuar edhe herë të tjera për t'u dhënë mundësi komenteve eventuale apo pyetjeve që mund të kenë kolegët, të cilët kanë qenë shumë aktivë dhe suportivë në të gjithë këtë nismë, po jua bëj të ditur edhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, dje është miratuar në komision në parim me të gjitha votat e anëtarëve të komisionit, duke vlerësuar sa delikat është problemi dhe sa shqetësues është për shoqërinë shqiptare dhe në problemet e ditës, pasi kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, ndaj duke pasur një frymë të tillë besoj se në këtë frymë duhet të ecë edhe dëgjesa e sotme.

Do t'u lutesha të gjithë pjesëmarrësve ashtu siç kanë qenë sintetikë në paraqitjen e materialeve të tyre, të cilat disponohen nga komisioni dhe administrohen, jo vetëm nga komisioni ynë, por edhe Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, në parashtresat që do të bëni të qëndroni në ato që ju do t'i zgjidhni si momentet më të spikatura të materialit tuaj dhe jo të gjithëçka, për të qenë sintetikë dhe që të mbeten disa gjëra që duhet të jenë rekord i komisionit, për të cilat ne do të insistojmë fort dhe ato gjëra, të cilat do të jenë shumë qenësore të përcillen në komisionin përgjegjës dhe pse jo të kenë reflektimin e tyre në draftin përfundimtar që do t'i shkojë seancës për miratim në mënyrë që procesi i përmirësimit të jetë më i plotë.

E them këtë, sepse pavarësisht se Komisioni për Punën dhe Çështjet Sociale është komision për dhënie mendimi, gjë që e kam pohuar edhe dje, për zgjedhje jo të komisionit, pjesëtarët e shoqërisë civile duhet ta dinë këtë, i kemi kërkuar Kuvendit me insistim që të mos jetë kështu. Për ta evituar një anormalitet të tillë, ka pasur një kokëfortësi që nuk e kam kuptuar dot, jua them sinqerisht, jam shumë i hapur me ju, megjithatë kjo nuk na pengon për të zhvilluar punën dhe misionin tonë për përmirësimin e ligjit, por edhe në komisionin përkatës do të insistojmë që gjithëçka që do të gjejmë me vend të përmirësohet, pasi ndjeshmëria në komisionin tonë është e ndryshme dhe më e lartë në raport me Komisionin e Çështjeve Ligjore dhe të gjithë së bashku të formësojmë një opinion, i cili atje ku ka nevojë për përmirësim të ndodhë, atje ku drafti është i konsoliduar dhe duket që në tërësinë e tij është i tillë të mbetet ashtu sikurse është propozuar.

Fillojmë me radhë.

A ka ndonjë preferencë ndonjëri prej jush dhe do ta marrë fjalën më së pari?

Zoti Hazizaj, fjala për ju.

Altin Hazizaj – Faleminderit!

Zoti kryetar i komisionit, ju falënderoj për ftesën në emër të Rrjetit Kombëtar “Vepro për Fëmijët”!

Dua t’ju përgëzoj për sa u takon takimeve të vazhdueshme dhe seancave dëgjimore me shoqërinë civile, sepse për mua brenda 2 javëve ose më saktë më pak se 2 javë kam qenë i pranishëm 3 herë në këtë komision, por kjo tregon nga ana tjetër pa diskutim edhe përkrahjen që ky komision i jep shoqërisë civile dhe faktit sesa i nevojshëm është që komisione të tilla parlamentare të konsultohen me shoqërinë civile. E para.

E dyta, pa diskutim, kjo është një deklaratë e përgjithshme, është fakti se ne mbështesim punën e mirë dhe të gjatë që ministria përgjegjëse për përgatitjen e këtyre ndryshimeve ligjore për ligjin “Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare” ka zhvilluar. Procesi ka qenë i hapur dhe me pjesëmarrje, prandaj mendoj që shoqëria civile edhe përgjatë procesit të përgatitjes së këtij projektligji ka marrë pjesë dhe ka pasur mundësi të japë kontribute. Ajo që unë dua të sjell sot në vëmendjen tuaj janë disa çështje thelbësore, prandaj do mundohem t’i kalojë me shumë shpejtësi, sepse e di që jemi shumë persona nga shoqëria civile.

Janë afërsisht 10 pika që kanë të bëjnë me çështjet më kryesore për sa u përket të drejtave të fëmijëve.

E para, ky nuk është ligji kryesor që rregullon çështjen e ndarjes së fëmijëve, sepse fëmijët kanë një ligj të posaçëm, prandaj ne e shohim këtë si një ligj komplementar, që rregullon thjesht vetëm dhunën në marrëdhëniet familjare, por jo të gjithë çështjen e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijëve. Kjo do të thotë se në parim ky ligj duhet të ketë të përfshirë, në mënyrë të detajuar do të thosha referenca të sakta që vijnë nga dy ligje të tjera që janë ligje thelbësore: ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”, i vitit 2017 dhe e dyta ligjin “Për kujdesin shoqëror në Shqipëri” i vitit 2016. Në disa momente shohim se te ky ligj ka munguar fryma e këtyre dy ligjeve.

Po e nis në bazë të çështjeve më kryesore, siç jua thashë.

E para, për sa i përket nenit 3/1 “Legjislacioni i zbatueshëm”, bindja jonë, këtë e them si jurist dhe si avokat, është që neni 3/1 i propozuar për t’u ndryshuar hyn në disa detaje të legjislacionit, të cilat janë të panevojshme. Teknika juridike, në fakt, kërkon që, kur themi marrëveshje ndërkombëtare, për aq kohë sa ka shumë marrëveshje ndërkombëtare në të cilat Shqipëria bëhet pjesë, nuk është e nevojshme t’i marrim ose t’i përmendëm me emër të përveçëm marrëdhëniet ose marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo për shkak, sepse si ligji i brendshëm, ashtu

edhe ligji ndërkombëtar zhvillohet në kohë, emrat ndryshojnë, mund të ketë akte të reja ndërkombëtare dhe vendosja e emrave specifike mund të kufizojë ose mund të kërkojë pastaj ndryshime të herëpashershme të ligjit.

Në këtë aspekt do të kërkonim eliminimin e referencave për konventa specifike, duke e lënë të qartë vetëm për aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, ku edhe teknika legislative e pranon këtë si çështje.

E dyta, ajo që ne kemi parë me shqetësim dhe mbase do të duhen personat përgjegjës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, është reflektimi që duhet të ketë ky ligj me referencat e sakta me ligjin për kujdesin shoqëror në Shqipëri. Ajo që shohim si shqetësim është fakti që në nenin 5, shkronja “c” dhe në vijim përgjatë gjithë tekstit të projektligjit të propozuar, mungojnë tipologjitë e shërbimeve të rekomanduara nga ligji për kujdesin shoqëror. Në bindjen tonë të gjitha tipologjitë e shërbimeve të përfshira në ligjin e kujdesit shoqëror duhen pa diskutim të përfshihen edhe në këtë ligj. Në mënyrë më specifike do të kërkonim dhe do të rekomandonim përfshirjen e Shërbimit të Trajtimin të Traumës së Dhunës në Familje, një shërbim që ekziston si tipologji, por në Shqipëri nuk është i zhvilluar dhe ndërkohë për shkak të mungesës së këtij shërbimi në realitet dhe në jetën e përditshme kemi viktimë që nuk trajtohen, nuk mbrohen dhe nuk marrin asnjë shërbim.

Në të njëjtën kohë mungon tipologjia me bazë komunitare që është po ashtu e njohur si tipologji në ligjin e kujdesit shoqëror dhe kjo patjetër duhet të përfshihet në këtë ligj. Po ashtu ne shohim disa terma të përgjithshëm po në nenin 5, siç është përdorimi i fjalës “të gjitha nevojave”. Pa diskutim ne si shoqëri civile themi se të gjitha nevojat duhet të përmbushen, por nga ana tjetër ka një kufizim në këtë aspekt dhe ky kufizim vjen prej asaj që janë nevojat ligjore, pra shteti ka detyrimin për t’i përmbushur apo janë nevoja të individit dhe që vetë individit mund t’i përmbushë. Në këtë aspekt do të rekomandonim që të përmbusheshin ato nevoja që janë të detyrueshme për shtetin.

Po në nenin 5, i cili është neni kryesor që ka të bëjë me përmbajtjen dhe gamën e shërbimeve që duhen ofruar, kërkojmë dhe rekomandojmë të shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje: “Mbështet ngritjen, funksionimin dhe financimin nga fondi social, VKM-ja përkatëse tashmë ka kaluar, të qendrave komunitare për trajtimin e traumës, pasojave të dhunës në qarqe dhe në rajone, të strehëzave për të rritur apo për fëmijë në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe organizatat jofitimprurëse të shoqërisë civile, por në fakt termi duhej të ishte OJF-të”. Këtë e vendosim në zbatim të VKM-së që ka të bëjë me ngritjen e fondit social në Shqipëri.

Rekomandimi nr. 4 ka të bëjë me nenin nr. 6, shkronja “c”, ku ne propozojmë që kjo pikë të shtohet me përmbajtjen si më poshtë, pasi është tepër e rëndësishme, sepse ka të bëjë me detyrimet që Policia e Shtetit nuk i ka përmbushur. Punonjës të policisë shpesh thonë se nuk e kanë për detyrë t’i përmbushin, por në bindjen tonë ata e kanë për detyrë t’i përmbushin ose duhet të jenë të detyrueshme për punonjësit e policisë dhe për Policinë e Shtetit.

Rekomandimi ynë për shkronjën “c” është që të ketë këtë përmbajtje: “Policia e Shtetit, çdo njësi policore ose punonjës policie, kur vihen në kontakt të drejtpërdrejtë me viktimën që i ka mbijetuar dhunës në familje, pra nuk është një person i vdekur, por i gjallë, pasi marrin deklaratën paraprake e shoqërojnë atë për te njësia më e afërt shëndetësore”. Pra, policia është e detyruar që, në momentin që vendoset kontakt me një person që i ka mbijetuar dhunës, ta shoqërojë këtë person. Pse? Rasti, në mos gabojmë i vitit 2014, ku një familje nga Malësia e Madhe bën sherr në Tiranë, bashkëshortët zihen, policia nuk i shoqëron, por thjesht i këshillon dhe ata pasi arrijnë në shtëpinë e tyre në Malësi të Madhe, bashkëshorti vret bashkëshorten.

Pra, kjo do të thotë se në jetën reale në qoftë se policia nuk merr përsipër të kryejë disa detyrime që ne i shohim tepër të rëndësishme, mendojmë, sidomos vajzat dhe gratë janë të rrezikuara që ato të mos jenë më të mbijetuarat e dhunës, por viktima të dhunës. Në këtë aspekt kërkojmë që policia ta ketë detyrimin për të shoqëruar çdo person që është viktimë e dhunës në familje te njësia më e afërt shëndetësore dhe ta informojnë personin që është viktimë e dhunës për të drejtat që ai ose ajo ka, shërbimet që mund të përfitojë dhe njëkohësisht të drejtën për të denoncuar çdo formë të dhunës në familje, por policia shpesh nuk e kryen këtë detyrë ligjore.

Njëkohësisht, me këto veprime punonjësit e policisë njoftojnë menjëherë Njësinë e Shërbimeve Shoqërore në bashki ose njësinë administrative përkatëse, sepse ajo që ndodh në të vërtetë është që Njësia e Shërbimeve Shoqërore në bashki, pavarësisht se është e detyruar të ofrojë shërbime nuk njoftohet për ngjarjen.

Për sa i përket pikës 5, që ka të bëjë me shërbimin shëndetësor, është një çështje që e prek komisionin tuaj, prandaj ne kërkojmë dhe propozojmë dy shtesa shkronjën “c” dhe shkronjën “d”, mbështetjen për ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës apo dhomave që shërbejnë si emergjenca pranë spitaleve ku viktima trajtohet.

E dyta, e cila është mjaft e rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve, të sigurohet që i gjithë personeli mjekësor që vendoset në kontakt me fëmijën viktimë të dhunës në familje të raportojë menjëherë te njësia më e afërt e mbrojtjes së fëmijës. Pra, detyrimi për të raportuar siç e kërkon edhe ligji për mbrojtjen e fëmijëve. Ligji aktual për masat e dhunës në familje nuk e parashikon këtë detyrim, prandaj ne kërkojmë që kjo të sanksionohet.

Për sa i përket rekomandimit nr. 6 që ka të bëjë përsëri me listën ose me shtesat që i bëhen këtij projektligji. Ky rekomandim, ka të bëjë me marrjen e masave për të parashikuar përfaqësuesin procedural të fëmijëve nga lista e punonjësve të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, prandaj ne kërkojmë që të shtohet: “Edhe nga lista e mbrojtësve kryesisht”. Ligji i ri i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2018 për ndihmën juridike që ofrohet nga shteti, sanksion që shteti shqiptar për të gjitha ato raste kur ka dhunë në familje ofron ndihmën e tij ligjore falas.

Për sa i përket rekomandimit tonë nr. 7, që ka të bëjë me nenin 6, për të ndjekur logjikën pika 3/1. Ne kërkojmë të shtohen edhe 3 shkronja të tjera, shkronjat “c”, “d” dhe “e”. Shkronja “c” ka të bëjë me krijimin dhe hapjen e programeve për eliminimin e agresionit. Ne nuk merremi me ushtruesin e dhunës, të cilët në 90% të rasteve janë burra, djem, të cilët në fakt kanë probleme me menaxhimin e agresionit, ky është termi dhe ne kemi nevojë të krijojmë programe të tilla.

E dyta, merren masa që stafi pedagogjik dhe stafi drejtues i shërbimit psikosocial nëpër shkolla të raportojnë çdo rast të dhunës në familje, por kjo sot nuk ndodh, sepse nuk konsiderohet pjesë e sistemit të mbrojtjes. Ajo që ne kërkojmë është që përpos rasteve të dhunës ndaj fëmijëve që ndodh në shumë mjedise, edhe dhuna në familje të jetë e raportueshme nga ana e shkollave dhe e atyre personave që e kanë për detyrë. I njëjti rekomandim është edhe shtesa për shkronjën “e”, me urdhër të ministrit merren masa për të ngritur një sistem të identifikimit, të regjistrimit dhe të raportimit të hershëm të dhunës, kjo është për Ministrinë e Arsimit si rekomandim, së dyshuar apo të konfirmuar në familje.

Sot shtetet kanë arritur të krijojnë sisteme të raportimit të hershëm, që do të thotë se që kopsht një fëmijë që tregon se ka sjellje agresive, nga natyra fëmija nuk duhet të ketë sjellje agresive, madje asnjë adoleshent, do të thotë se ka shkaqe të arsyeshme të dyshohet se ky fëmijë mund të jetë pre ose e dhunës ndaj tij, seksuale apo fizike, ose e neglizhencës dhe pa diskutim ai ose ajo kanë shfaqje të dhunës në familje dhe fëmijët janë pasqyra se çfarë ndodh në familje.

Ne kemi nevojë që shkollat të jenë të përgatitura për çdo rast, ku ato mendojnë se kur ka një agresion, ose atje ku ka një shprehje të sjelljes së pajustificuar të fëmijës, sjellje antisociale siç i referohemi ne në gjuhën tonë, atëherë këto raste duhen raportuar dhe duhen shqyrtuar, sepse në shumicën e rasteve jeta ka treguar që këta fëmijë ose janë viktimë të dhunës, ose jetojnë në një mjedis të dhunshëm.

Rekomandimi ynë nr. 8 ka të bëjë me pikën 4 po të nenit 6, ku ne rekomandojmë që të shtohet në pikën 4, shkronja “b”. Pra, të thuhet: “Në bashkëpunim me OJF-të financohet ngritja dhe funksionimi i qendrave psikosociale të reja apo atyre ekzistuese të strehimit të përkohshëm, të trajtimit të traumës për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës në familje, për

trajtimin e menjëhershëm edhe në vijueshmëri të viktimave të dhunës në familje”. Kjo do të mbulonte të gjithë procesin nga momenti kur ndodh dhuna deri në eliminimin e saj.

Pika 5 e nenit 6 ka të bëjë me ministrinë përgjegjëse për strehimin social. Në ligjin e ri, të miratuar, për strehimin social ne rekomandojmë të hiqet “përsëritja”, sepse, në fakt, ky ligj i ri i rregullon të gjitha çështjet e strehimit për dhunën, përfshirë edhe strehëzat.

Rekomandimi ynë i 9-të ka të bëjë me nenin 7 pika 1 “Garancia për mbrojtjen”, ku ne rekomandojmë që të shtohet një fjali: “Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose shërbime të tjera të kërkuara, shoqërimin drejt shërbimeve të urgjencës ose shërbimet mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimit të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje”. Kjo do të garantonte që çdo autoritet ta asistojë viktimën gjatë të gjithë procesit, i cili është detyrim edhe kushtetues.

Rekomandimi i parafundit ka të bëjë me nenin 9, pika 10, që ka të bëjë me prindin dhunues. Ne rekomandojmë që te germa ”j” e nenit 9 të shtohet edhe një fjali e dytë: “Prindit dhunues mund t’i kthehet përgjegjësia prindërore ose kujdestaria vetëm nëse gjykata çmon bazuar te raportet e lëshuara, te shërbimi shoqëror në njësinë e qeverisjes vendore, te shërbimi psikosocial ku fëmija merr shërbime dhe, sipas rastit, te psikologu i shkollës, që fëmija nuk paraqet rrezik për t’u ribërë viktimë e dhunës në familje. Po për këtë qëllim gjykata mund të caktojë me vendim të saj të drejtën që punonjësi social, i autorizuar nga shërbimi shoqëror në njësinë e qeverisjes vendore, të takohet me fëmijën viktimë të dhunës sa herë e çmon të domosdoshme. Kjo do të thotë që çdo punonjësi që është i punësuar për të ofruar shërbimet sociale në bashki, t’i garantohet e drejta e vizitës në familje. Nëse ekziston dyshimi që prindi përsëri ushtron dhunë, atëherë gjykata vendos heqjen e përhershme të përgjegjësisë prindërore ndaj prindit dhunues”. Është një qëndrim, i marrë nga eksperiencia e shteteve të zhvilluara. Si eksperiencia britanike, si ajo suedeze, si ajo amerikane, është që, nëse prindi për herë të dytë ose të tretë godet fëmijën, automatikisht atij prindi i hiqet përgjegjësia prindërore përgjithnjë. Gjykatat i garantojnë atij të drejtat vizituese. E drejta vizituese do të thotë që prindi i një fëmije, mund ta shikoj fëmijën, por nuk mund të kem përgjegjësi për të vendosur për jetën e atij fëmije.

Së fundi, ka të bëjë me një referencë sa u përket dy urdhrave specifikë, Urdhrit të Psikologut dhe Urdhrit të Punonjësit Social.

Së pari, pavarësisht se ligji për ngritjen e Urdhrit të Punonjësit Social është miratuar, ai nuk është ngritur.

Së dyti, Urdhri i Psikologut, pavarësisht se është ngritur, ende nuk është i mandatuar për të ofruar trajnime nga autoriteti përgjegjës që është Ministria e Arsimit. Kështu që, në këtë aspekt, ne rekomandojmë t’i hiqen të gjitha referencat sa u përket urdhrave specifikë, siç është

Urdhri i Psikologut dhe Urdhri i Punonjësit Social për të ofruar trajnime, sepse, në fakt, ajo që duhet të vendoset në ligj është se këto trajnime bëhen nga agjencitë e akredituara. Unë mendoj se do të ishte në shkelje të ligjit që të vendosen emrat e dy urdhrave, kur, në fakt, ato nuk janë të akredituar për të ofruar trajnime.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit, Altin!

Parashtresa ishte shumë e mirë. Marrëveshja nuk ishte shumë e mirë, sepse nuk ishit atje ku duhet, në kohën e duhur. Shembulli i Altinit duhet ndjekur për cilësinë, por jo për kohën. Gjërat që spikasin është e mira të dëgjohen nga komisioni, pasi gjithçka që ju keni sjellë do të jetë në tabelën shoqëruese që ne do t'i çojmë komisionit përkatës, ku do të jetë edhe propozimi alternativ i sjellë nga ju.

Personalisht ju mbështes, nuk ka asgjë të tepruar, madje në shumë vende plotësimet janë të nevojshme, me qëllim që të mos sillen prapë pas disa muajsh. Duhet të jetë edhe dashamirësia e Komisionit të Ligjeve për t'i përfshirë në draftin përfundimtar që shkon në seancë.

Personalisht them se janë jo vetëm të gjetura, por plotësojnë shumë boshllëqe që janë konstatuar prej kohësh. Shpresoj që të kenë një fat të mirë që të miratohen!

Do të doja të kaloja te Komisioneri për Mbrojtjen nga Rrezatimi.

Zoti Gajda, faleminderit për prezencë, do t'ju lutesha që brenda 3-4 minutave të bëni prezantimin.

Robert Gajda- Faleminderit për ftesën!

Do të mundohem të flas shkurt, pasi komentet janë reflektuar në shkresën që ju është dërguar.

Ajo që ka pasur më shumë vëmendjen tonë janë nenet e para të ligjit ekzistues dhe modifikimi që lidhet në aspektin e gruas.

Së pari, në relacion janë vendosur konventa që lidhen me dhunën në familje, dhunën ndaj gruas, si dhe për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas. Kështu që mendojmë se sa i përket vëmendjes që ligji u kushton disa kategorive ku përfshihen fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit mendojmë që të shtohet edhe gruaja, për shkak të mbrojtjes së veçantë që ka në Kushtetutë, në konventat që janë referuar këtij ligji, por edhe për shkak të specifikave që paraqet dhuna në familje me bazë gjinore dhe kryesisht te gruaja. Kjo do të gjeneronte edhe zgjerimin e përkufizimeve duke futur edhe konceptin e dhunës ndaj gruas, i cili duhet të merret ai që përdoret në konventën kundër dhunës dhe marrëdhënieve familjare.

Një ndryshim tjetër që do të donim është edhe shtimi i dy pikave të tjera në nenin 1 të projektligjit, që lidhet edhe me shtimin e pikave 3 dhe 4. Janë dy shtesa që marrin shkas nga

konventa për dhunën ndaj gruas dhe në familje, të cilat lidhen me zgjerimin ose parashikimin e këtyre masave, duke përfshirë që edhe shkaqet e diskriminimit të parashikohen në legjislacionin shqiptar.

Pra, pas pikës 2 të nenit 1 të shtohet pika sipas së cilës zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave sigurohen pa diskriminim për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi. Ne kemi propozuar që të përmenden të gjitha shkaqet e diskriminimit. Aty janë disa fjalë me shkronja italiane, të cilat janë marrë nga ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe i janë shtuar asaj që konventa ka. Pra, është më e gjerë duke përmendur të gjitha shkaqet e diskriminimit që ne kemi hasur, por duke lënë edhe dritaren e fundit ose çdo shkak tjetër që lidhet me specifika ose raste konkrete që paraqiten, që mbase nuk hyjnë në asnjë shkak të parashikuar, por mbetet.

Nëse mendoni që nuk doni t'i përfshini të gjitha shkaqet, formulimi mund të jetë: "Për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi...". Është çështje teknike legjislative, nëse doni të jenë të shënuara të gjitha shkaqet, ose të jenë të paraqitura në mënyrë më të përgjithshme.

Së fundi, kemi një formulim në shtesën e pikës 4, i cili në këndvështrimin tonë ishte i paqartë dhe ne jemi munduar ta riformulojmë. Këtu bëhet fjalë për masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 10 dhe që lidhen me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, ose urdhrin paraprak të menjëhershëm të mbrojtjes. Këtu shqetësimi është që, nëse do të lidhet me ato kategori që i dedikuar një vëmendje të veçantë dhe që janë gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, mundet të jetë edhe problemi i konsiderimit të tyre si masa diskriminuese. Ndërkohë që nuk është problem, pasi për këto kategori, masat që merren quhen masa pozitive në vetvete, pra janë masa që ndërmerren dhe nuk mund të mos konsiderohen diskriminuese në kuptimin negativ, por konsiderohen masa që duhen ndërmarrë për shkak të vëmendjes së veçantë që u dedikohet këtyre kategorive.

Prandaj, formulimi që kemi propozuar dhe mendojmë që qëndron është që masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji si edhe ato të ndërmarrë nga Policia e Shtetit nëpërmjet urdhrin paraprak të menjëhershëm të mbrojtjes në lidhje me kategoritë që gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas pikës 2 të nenit 1 nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas kushteve të këtij ligji. Edhe ky formulim merr shkas nga konventat dhe janë formuluar për t'u përqasur më mirë në lidhje me ligjin që po flasim.

Këto janë rekomandimet tona, por që i gjeni më mirë të arsyetuara në shkresën që ju është dërguar.

Petrit Vasili- Faleminderit!

Unë besoj se nga pikëpamja formale ndaj me të gjithë kolegët që citimi i konventave në një projektligj të caktuar është një kufizim, pasi ka një proces politik në vijimësi, ku proceset ecin dhe ka një dinamikë të caktuar edhe në rishikimin e konventave dhe përditësimit të tyre, që do ta bënte ligjin të hynte në konflikt të vazhdueshëm, kurse kjo është një qasje më flksesibël dhe lejon që atje ku ata dominojnë, ligji automatikisht reflekton mbi to.

Fjalën e ka zonja Blerta Cani nga “Fondacioni për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Blerta Cani - Faleminderit!

Unë, përveçse si përfaqësuese e fondacionit vij edhe si anëtare e “Rrjetit të Monitorimit të Dhunës me Bazë Gjinore”, një bashkim organizatash, i cili synon të bashkojë forcat për të fuqizuar zërin dhe për të arritur rezultate në drejtim të minimizimit të këtij fenomeni. Unë do të flas për rekomandimet që ne kemi dërguar sa i përket kategorisë së grave me aftësi të kufizuara.

Raportet më të fundit kanë treguar që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përjetojnë një diskriminim të dyfishtë. Raporti i fundit është i GREVIO-s, i vitit 2017, ku Shqipëria është pjesë. Ato e kanë të vështirë dhe të pamundur të dalin nga rrethi vicioz i dhunës. Dhunuesit mund të mos janë bashkëshortët, por kujdestarët dhe familjarët e tyre. Gratë me aftësi të kufizuara intelektuale dhe ato me shëndet mendor janë më së shumti viktimat të dhunës në këtë kategori. Ndërkohë që edhe vetë gratë me aftësi të kufizuara janë të painformuara për mundësitë që ato kanë për të marrë shërbimet në këto qendra që ofrojnë shërbime për të gjitha gratë viktimat të dhunës.

Rekomandimet tona janë në përputhje me përmirësimin e disa prej këtyre problematikave që edhe raporti i GREVIO-s, por edhe raporte të tjera, si në vend, ashtu edhe ndërkombëtare kanë trajtuar për këtë kategori.

Një nga rekomandimet është për shtimin e disa elementeve që lidhen me kujdestarin me pagesë ose ndihmësin personal, pasi dhunuesi është edhe një pjesëtar i familjes ose/dhe jo vetëm bashkëshorti. Kështu që duhet të ketë disa modifikime në këtë pjesë të terminologjisë.

Rekomandimi tjetër është për përfshirjen në këtë projektligj të termit “të përshtatjes së arsyeshme”, që janë modifikime dhe rregullime të nevojshme për të garantuar që edhe gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës të marrin shërbimet e duhura si edhe gratë e vajzat e tjera viktimat të dhunës.

Një nga elementet e përshtatjes së arsyeshme është edhe aksesueshmëria për të cilën ne kemi një ligj të posaçëm, i cili është ligji për përshtatjen dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëri do të thotë që të gjitha shërbimet dhe institucionet që ofrojnë

shërbime për gratë e dhunuara mund të marrin masa për të ofruar informacionin e përshtatshëm, komunikimin, ambientet me qëllim që ato të informohen të marrin shërbime njëlloj si gratë tjera.

Ndërkohë diçka tjetër që ne kemi rekomanduar ka të bëjë me mostrajtimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me probleme të shëndetit mendor sidomos në rastet kur atyre u është hequr zotësia juridike për të vepruar dhe dhuna që ushtrohet nga kujdestarët e tyre shkon në linjë me konceptin e vendimmarrjes së mbështetur, i cili është një koncept që jo vetëm rekomandohet nga konventat, por është i përfshirë edhe në ligjin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë.

Së fundi, në lidhje me gratë dhe vajzat e mbyllura në institucionet rezidenciale, ky ligj nuk ka parashikime për këtë kategori pasi është një kategori, e cila jeton përjetësisht në qendra rehabilitimi ose institucione rezidenciale dhe për të cilat duhet të merren masa të eliminohet çdo lloj dhune e ushtuar ndaj tyre në ato qendra ku ato jetojnë.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Po, zonja Oltiana.

Oltiana Andrea - Unë jam avokate pranë “Qendrës për të drejtat e njeriut në demokraci”. Neve, në fakt, jemi pjesë e monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe do të doja të falënderoja këtë komision edhe në emër të rrjetit, sepse neve na u dha mundësia për të diskutuar në lidhje me ligjin bazë për rregullimin e çështjeve të dhunës në familje. Ne e konsiderojmë këtë si një moment shumë të rëndësishëm dhe si një mundësi shumë të mirë për të diskutuar dhe për të sjellë opinionet dhe sugjerimet tona.

Në nenin 2 të projektligjit propozojmë që germa “d” e projektit të ndryshojë si vijon te fjalia: “Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit dhe bashkëshortet/bashkëjetueset”, të hiqet togfjalëshi “kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit”, sepse ky lloj kufizimi 3 muaj nuk ka asnjë lloj logjike juridike, dhe, në fakt, nuk ka asnjë logjikë të bazuar edhe në praktikë. Nga studimi i qendrës “Të drejtat e njeriut në demokraci”, për vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitet 2016-2017, rezulton se në 10% të çështjeve janë pikërisht kunata dhe kunati ata që ushtrojnë dhunën në marrëdhëniet familjare. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me një numër të madh rastesh, ku subjektet e këtij ligji janë pikërisht kunati dhe kunata. Vetvetiu lind pyetja: pse duhet të ekzistojë një kufizim i tillë kohor, 3-mujor, që shpeshherë, nga praktika në gjykatë edhe si avokat, e shikojmë që bëhet problem kryesor edhe për legjitimitimin e palëve, ndërkohë që kemi të bëjmë me një konflikt shumë të mprehtë në familje? Ndaj mendojmë që ky lloj kufizimi kohor, që nuk mbështetet aspak në logjikën juridike, por edhe në praktikë, duhet të hiqet nga ky ligj.

Ndërkohë, nëse i referohemi nenit 10 të këtij projekti, pas pikës 4, propozojmë të shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “Gjykata mund të parashikojë edhe masa të tjera që u përshtaten më mirë rrethanave dhe, që, sipas rastit, ndihmojnë mbrojtjen e integritetit të paditëses, por në asnjë rast nuk mund të japë urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje për të dyja palët ndërgjyqëse njëkohësisht, ose përgjatë zbatimit të urdhrit të mbrojtjes”.

Rrjeti propozon një hapje të urdhrit të mbrojtjes, që i lë më shumë hapësirë gjyqtarit për të vepruar sipas bindjes së tij të brendshme. Mendojmë se nevojitet krijimi i një listë joshteruese të masave mbrojtëse, sepse aktualisht kemi të bëjmë me një listë joshteruese me masa mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji. Propozojmë të kemi një listë të hapur, pasi praktika është shumë e larmishme, kemi të bëjmë me çështje që i përkasin familjes, përmbajnë specifika të shumta, dhe për këtë arsye gjyqtarëve duhet t’u lihet më tepër hapësirë në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Mendojmë që hapja e urdhrit të mbrojtjes nëpërmjet një liste joshteruese do t’i jepte mundësi dhe diskrecion gjyqtarit të vendoste masa mbrojtëse rast pas rasti.

Ndërkohë, ne e shikojmë si diçka aspak efektive dhe të logjikshme dhënien e urdhrit të mbrojtjes në mënyrë të njëkohshme për të dyja palët, për viktimën dhe dhunuesin. Është alogjike të kemi një urdhër mbrojtjeje të tillë, aq më tepër që ekzekutimi i këtij urdhri mbrojtjeje është praktikisht i pamundur.

Gjithashtu, në nenin 17/2 të projektligjit të paraqitur propozojmë që pas pikës 3/1, të shtohet pika 3/2 me përmbajtjen që vijon: në nenin 10, germa “c” e ligjit: “20 ditë përpara përfundimit të afatit të urdhrit të mbrojtjes, i padituri, dhunuesi, i drejtohet gjykatës me kërkesën që të lëshojë autorizimin për të rihyrë në banesë duke filluar nga dita e nesërme e përfundimit të afatit të urdhrit të mbrojtjes. Kërkesa shoqërohet me vërtetim të lëshuar nga Policia e Shtetit dhe nga koordinatori vendor i sistemit të referimit, ose në mungesë të tij, nga Zyra Vendore e Shërbimeve Sociale”.

Nga puna në praktikë si organizata të këtij rrjeti, ajo që ka rezultuar është se ka një sërë problematikash, ndër to është rasti i rikthimit në banesë i dhunuesit, pasi mbaron efekti i vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes. Në fakt, një problematikë e tillë na është shprehur edhe nga ana e punonjësve të policisë, të cilët merren drejtpërdrejt me rastet e dhunës në familje.

Për më tepër shqetësimi ynë është të parandalohen incidentet e tjera të dhunës, sepse ka ndodhur në praktikë, që menjëherë pasi ka përfunduar urdhri i mbrojtjes, ku gjykata ka vendosur masën e mbrojtjes së largimit nga banesa të dhunuesit, ky i fundit, ditën që përfundon urdhri i mbrojtjes kthehet menjëherë në banesë duke u bërë shpesh shkak i konflikteve të mëtejshme.

Ligji parashikon të lëshohet një autorizim në momentin që dhunuesi kthehet në banesë pasi është larguar me vendim gjyqësor, por ajo që ndodh në praktikë është se një autorizim i tillë nuk lëshohet nga ana e gjykatës dhe nuk ka një rregullim të mirëpërcaktuar në lidhje me lëshimin e tij.

Ndaj, kërkojmë që të përcaktohet në mënyrë të detajuar, siç e përmenda më sipër, mënyra e rikthimit në banesë të dhunuesit pas përfundimit të efekteve të urdhrin të mbrojtjes. E mbështesim këtë propozim që bëjmë edhe në monitorimin dhe studimin që përmenda më sipër, ku për periudhën 2016-2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur largimin nga banesa të dhunuesve në 28% të çështjeve, që do të thotë se kemi një numër të lartë çështjesh me vendosjen e një mase të tillë mbrojtjeje.

Për këtë arsye e shikojmë shumë të arsyeshme rregullimin ligjor të rikthimit të banuesit në banesë, pasi shumë shpesh bëhet subjekt i konflikteve.

Në fakt, mund të jetë te ligji për strehimin social, por mendojmë që edhe ky ligj duhet ta ketë të specifikuar, sepse është një ligj që rregullon në mënyrë direkte çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Pas pikës 3/2, të shtohet pika 3/3 me përmbajtjen që vijon: “Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin e mbrojtjes, efektivet e policisë, në bashkëpunim me punonjësit socialë dhe koordinatorin vendor të njësisë vendore përkatëse, njoftojnë në çdo rast viktimën e dhunës së marrë në mbrojtje në lidhje me ndryshimin e vendndodhjes, liritimit, apo liritimit të përkohshëm të dhunuesit”.

Ajo që ndodh në fakt, është që në momentin që dhunuesi del nga burgu, sepse ka një numër të madh rastesh ku si masë sigurimi vendoset arrestimi në burg i dhunuesit, ose mbase dhunuesi vuan dënimin, apo ka dalë me një dënim alternativ, viktimja e dhunës në familje nuk informohet lidhur me lirimimin e dhunuesit të saj. Këtë propozim që bëjmë, që viktimja në çdo rast të informohet në lidhje me rikthimin në banesë të dhunuesit, e mbështesim edhe në nenin 56 të Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, ku parashikohet e drejta e viktimës së dhunës për t’u informuar kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht, apo përfundimisht.

Në lidhje me nenin 22, të po këtij ligji, propozojmë që germa “c” e ligjit ekzistues të ndryshojë si vijon: “Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, si dhe çdo subjekt që ka vënë në lëvizje gjykatën, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrohet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij”.

Me këtë shtesë ne kërkojmë që veçanërisht, policia dhe prokuroria, por edhe subjektet e tjera të njohura nga ligji të vënë në lëvizje gjykatën të kërkojnë një urdhrë mbrojtjeje, kur janë kërkuar në këtë gjykim. Kjo buron nga pozita e tyre procedurale. Ata mund ta bëjnë një kërkesë të tillë edhe sipas rregullave të përgjithshme të Kodit Civil, por kjo ka ndodhur shumë rrallë.

Së fundi, në lidhje me nenin 17/2 të projektligjit të paraqitur, në pikën 3/1, propozojmë të bëhet ndryshimi si vijon, duke hequr togfjalëshin çdo “60 (gjashtëdhjetë) ditë”: “Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për urdhrin e mbrojtjes së menjëhershëm, Zyra e Shërbimeve Sociale të njësisë vendore në bashkëpunim me rajonin e policisë, monitorojnë respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga palët dhe përgatisin raporte periodikisht, në çdo rast jo më pak se një, për të cilin vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm”.

Dispozita përshtatet më mirë dhe forcohen shanset që të gjejë zbatim, sipas nevojave. Ajo u përgjigjet afateve të ndryshme që mund të kenë urdhrat e mbrojtjes, ose urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes. Kështu, mund të ndodhë që urdhri i mbrojtjes të ketë edhe 30 ditë afat, ndërkohë që afati i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes është më i shkurtër. Nga ana tjetër, dispozita u përgjigjet më mirë mundësive të ndryshme që mund të kenë njësitë vendore.

Pra, kërkojmë një reduktim të këtij afati nga 60 ditë në 30 ditë, duke marrë parasysh specifikat që ka urdhri i mbrojtjes.

Ju falënderoj!

Petrit Vasili - Faleminderit për parashtesën e detajuar, edhe për vërejtjet!

Është momenti për të hapur diskutimin me kolegët.

Kam vetëm një pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Çështjeve Sociale, por edhe për të gjithë të ftuarit: praktikisht, në komision janë depozituar mjaft vërejtje apo përmirësimet që i propozohen një ligji, i cili është në frymën e duhur. Pyetja ime është kjo: cili ka qenë raporti në momentin e përgatitjes së kësaj nisme midis përfaqësuesve të shoqërisë civile, që janë shumë aktivë, por edhe profesionalë, madje kjo është një nga kualitetet e shtuara të tyre, dhe ministrisë, pasi mendoj që një bashkëpunim më efektiv dhe konstruktiv mes tyre mund t’i kishte eliminuar këto, nuk është ndonjë herezi, është shumë mirë që diskutohen këtu, por sa më shumë të tirreshin rrugës, do të ishte më mirë?

Fjala për zonjën Xhafaj.

Merita Xhafaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Në vlerësim të opinioneve të të gjithë përfaqësuesve të organizatave, ndjehem e keqardhur që nuk janë disa organizata që kanë një rol të fuqishëm në fushën e dhunës karshi grave, siç janë: shoqata “Refleksion”, e cila ka ngritur mekanizmin e referimit kundër dhunës, së bashku me një koalicion organizatash të tjera, po kështu “Linja e Këshillimit të Grave dhe Vajzave”, viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Lidhur me komentet e paraqitura këtu, së pari, do ta nisja nga komentet e Komisionerit Kundër Diskriminimit, të cilat i kemi marrë me shkrim dhe janë të reflektuara. Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë, pavarësisht se Komisioneri e ka marrë detyrën më pas. Mendimet janë me shkrim, ndodhen edhe në sistem që nga momenti që është çuar për miratim në Këshillin e Ministrave si projektvendim. Realisht ka një diferencë ndërmjet ligjit bazë, mbi të cilin janë bërë amendimet dhe propozimet, sepse gratë janë objekt i këtij ligji në masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare në ligjin bazë, pra nuk është përsëritur si terminologji. Në qoftë se do ta lidhnim me përkufizimin për dhunën ndaj grave, do të doja t’ju informoja që studimi për këto ndryshime, nga profesoret Aurela Anastasi, Arta Mandro dhe Mariana Semini, ka filluar herët dhe ne kemi përfunduar si domosdoshmëri këtë material dhe këto amendime të ligjit ekzistues.

Referuar 19 rekomandimeve urgjente, të cilat janë të detyrueshme për zbatim deri në vitin 2021 nga GREVIO, komuniteti që monitoron zbatimin e konventës së Stambollit, kemi filluar procesin për hartimin e ligjit kuadër për të gjitha format e dhunës ndaj grave, të cilat përfshijnë: dhunën në marrëdhëniet familjare, dhunën me bazë gjinore, seksuale, fizike, psikologjike, dhe kjo ka një spektër më të gjerë dhe do kohën e vetë.

Një pjesë e komenteve të trajtuara sot nga shoqëria civile apo të ardhura me shkrim, me të cilat ne jemi njohur që dje pasdite pasi përfunduam, kanë të bëjnë me format e ndryshme të dhunës ndaj grave. Dhuna në marrëdhëniet familjare është e një forme të veçantë, që përfshin të gjithë familjarët. Kjo është arsyeja që për herë të parë është përfshirë edhe rasti që përmendi zonja për të afërmit, e shprehur në terminologjinë juridike, sepse kemi pasur rastet e fundit, apo edhe më parë, raporte të tilla që ka ndodhur dhunë qoftë edhe me pasojë kriminale për rastet kur bashkëjetojnë, të dashur apo marrëdhënie të tilla të afërta. Këto njihen në teknikën legislative dhe, natyrisht, terminologjia e përdorur këtu, është terminologji, e cila përdoret në teknikën legislative, pra, nuk është e vendosur nga ne.

Në aspektin e problematikave të ngritura nga zoti Hazizaj, i cili është edhe anëtar i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe, realisht, këto problematika i ka shprehur edhe atje, ka qenë një nga hartuesit e ligjit të parë bazë, në grupin e punës, disa nga këto problematika i gjej me vend, ndërsa disa kapërcejnë fushën e veprimit të këtij ligji, që do të thotë se kalojnë përtej ligjit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ashtu sikurse ka raste që ka mbivendosje të

ligjit të shërbimeve, pasi nuk është e nevojshme të kemi përsëritje, apo të trajtimit të viktimave të dhunës me shërbime shoqërore të përcaktuara në ligjin “Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Nga ana tjetër, do të thosha se një pjesë e problematikave të ngritura do të mbulohen me aktet nënligjore, sepse edhe në zbatim të këtij ligji do të dalin aktet nënligjore, për shembull: “Tipologjitë e shërbimeve”, nuk mund të shënohen brenda një ligji për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, sepse fokusohemi dhe synojmë parandalimin, pjesa e shërbimeve vjen më pas. Natyrisht, është e përcaktuar dhe e detajuar në ligjin e shërbimeve dhe në projektvendimin që po bëjmë, i cili shumë shpejt do të kalojë në Këshillin e Ministrave për shportën e shërbimeve, që do të thotë se është e gjitha procedurë e një ligji tjetër. Nuk mund të kemi mbivendosje dhe përsëritje.

Lidhur me pjesën e raportimit dhe nxjerrjes së urdhrave, në eksperiencën time, në monitorimin që u bëjmë rasteve në marrëdhëniet familjare, dhe në mënyrë të veçantë nëpërmjet një sistemi REVALB, që është i ngritur dhe funksionon, ku hedhin të dhënat të gjithë koordinatorët për dhunën në njësitë e vetëqeverisjes vendore, por edhe pikat vokale të dhunës në nivel qendror, nuk kam pasur asnjë rast që të ketë një urdhër mbrojtjeje për dhunuesin dhe për viktimën. Është hera e parë që e dëgjoj këtu. Arsyeja që ka dalë këtu, në projektvendimin e diskutuar dhe e konsultuar me grupet e interesit nuk ka qenë pjesa e detyrimit të policisë për nxjerrjen e urdhrit paraprak të menjëhershëm të mbrojtjes.

Pikën tonë vokale në polici për barazinë gjinore, që është një nga pikat më të mira, kemi fat që e kemi, e kanë ngritur si problem që duhet të trajtohet detyrimisht në këtë ligj. Ne e kemi përfshirë dhe trajtuar në të.

Lidhur me pjesën e afatit të raporteve të përgatitura nga Shërbimi Social Shtetëror mund të mos jetë 60 ditë, pavarësisht se unë jam këtu për të mbrojtur variantin që ka ardhur nga qeveria, por natyrisht të jemi të hapur të marrim në konsideratë edhe ato komente, të cilat te përfutuesit janë më shumë të prekshme, sepse 60 ditë mund të mos jetë një afat që konvenon, mund të jetë më i shkurtër apo sipas rastit kjo mund edhe të tolerohet.

Sa i takon pjesës së fëmijëve, për shembull, ky ligj si risi ka trajtimin e fëmijëve që janë viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare, gjë që ligji i mëparshëm nuk e kishte në fokus, por trajtohej bashkërisht me nënën. Natyrisht, në trajtimin e rasteve të fëmijëve, të cilët janë viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare do pak më shumë kujdes, sepse ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve e ka marrë në konsideratë këtë.

Nga ana tjetër, është shumë i vlerësuar edhe nga strukturat ndërkombëtare fakti që ne së fundi kemi edhe një Kod Penal për të Miturit. Në këtë kontekst, jo vetëm që merr në konsideratë fëmijët, por vlerëson edhe mendimin e tyre duke u dhënë atyre të drejtën të shprehën.

Prioritetet është që duhet t'i qëndrojmë besnik fushës së mbulimit të këtij ligji, pra këtu flitet për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.

Lidhur me personat me aftësi të kufizuar, natyrisht ka një ligj tjetër, i cili i trajton. Po kështu është ligji “Për shërbimet shoqërore”, ligji “Për strehimin social”, që shumë shpejt do të pasurohet edhe me aktet nënligjore të tij dhe natyrisht, aty do të ketë edhe vëmendjen e veçantë, por do të doja t'ju sillja në vëmendje që jemi duke punuar për përgatitjen e një draft-vendimi të Këshillit të Ministrave për ndihmësin personal për personat me aftësi të kufizuar, një pozicion, i cili do të ketë edhe të drejtat, sanksionet apo kufizimet për veprimet e padrejta apo dhunuese që mund të kryejë kujdestari apo ndihmësi personal karshi personave me aftësi të kufizuar.

Nga ana tjetër, në referencat e konventave, arsyeja pse në mënyrë specifike kemi vendosur Konventën e Stambollit, është një detyrim që ne të bëjmë një ndryshim në ligjin ekzistues, përtej faktit që është edhe detyrimi tjetër që të përgatisim një ligj kuadër. Thashë që afati i zbatimit të 19 rekomandimeve urgjente është në vitin 2021 dhe jemi duke punuar për këtë pjesë.

Doja të sqaroja pjesën e urdhrin të psikologut dhe të punonjësit social: natyrisht që ne kemi vendosur urdhrin e psikologut dhe të punonjësit social, sepse deri në momentin që do të bëhen aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, do të bëhet funksional dhe do të akreditohet edhe urdhri profesional. Me punonjësit socialë kemi pasur një problem të vogël me grupet e interesit për një nen që do ta risjellim në parlament për rishikim dhe kjo është arsyeja pse nuk është ngritur akoma, por deri tani ne jemi duke punuar për trajnimin e gjitha pikave fokale të barazisë gjinore dhe koordinatorëve të dhunës më APS-ën, kjo për arsye se Grevio nuk ka na pranuar në raport jo vetëm trajnimet e shoqërisë civile, por nuk kanë njohur në mënyrë kategorike, as ato të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe as tekstet e Shkollës së Magjistraturës. Kushti dhe detyrimi i Konventës së Stambollit është që të gjitha programet e trajnimit për punonjësit që punojnë me viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare apo të dhunës ndaj grave dhe ndaj fëmijëve, në kuptimin e Konventës së Stambollit, të miratohen vetëm nga autoriteti përgjegjës për barazinë gjinore, që do të thotë, nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale. Asnjë tekst dhe asnjë program i miratuar nga Ministria e Arsimit nuk na është pranuar.

Në këtë kontekst ne kemi bërë një marrëveshje me ASP-ën dhe, me qëllim që të jenë të akredituara të gjitha trajnimet dhe certifikimet e punonjësve të shtetit, pikave fokale dhe atyre që punojnë në shëndetësi, në polici dhe në arsim, certifikimi dhe miratimi i programeve të trajnimit bëhet nëpërmjet ASP-ës.

Kaq mund t'ju sjell në vëmendje. Ato që janë të lidhura me teknikën legislative, me veprimet dhe vendimet e gjykatave, janë të parashikuara në Kodin Penal. Nëse nga pikëpamja e

teknikës legislative të këtij ndryshimi ligjor që ne kemi propozuar, ka gjëra që mund të përmirësohen, ne jemi të hapur, sepse qëllimi ynë është të ndihmojmë sa më shumë strukturat, që punojnë me viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, gjithmonë në këtë fushë jo vetëm në drejtim të teknikës legislative, pa ndërhyrë në kompetencat e institucioneve si gjykata, policia, apo institucionet e tjera.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Xhafaj!

Do të bëj vetëm një sqarim për komisionin, pasi ju shprehët keqardhjen për mospraninë e disa organizatave joqeveritare, unë po ju them se janë ftuar të gjitha, por ka qenë në zgjedhjen e tyre që të marrin pjesë ose jo. Maksimumi që ne si komision mund të bëjmë është të jemi të hapur për t'i dëgjuar të gjithë. Kushdo që gjykon të mos vijë është në zgjedhjen e tij, ka nga ata që gjykojnë të parin pjesë duke qenë jo drejtpërdrejt komunikues me komisionin, apo dëgjues. Ne kemi respektuar zgjedhjen e secilës shoqatë më vete, kështu që nuk dua të ketë asnjë hije apo ide se kemi pasur ndonjë preferencë në zgjedhjen e tyre. Njoftimi shkon tek të gjithë aktorët e interesuar, por ne nuk u imponohemi, nuk kemi arsye pse t'u lutemi përfaqësuesve të shoqërisë civile që të marrin pjesë në një forum maksimalisht të lartë, siç është komisioni parlamentar. Besoj është pozitive për secilin aktor që të jetë bashkëpunues dhe bashkëbisedues me ne. Kështu që kjo pikë ka këtë shpjegim.

Lidhur me çështjet e shumta që ju ngritët, nëse keni ndonjë ndërhyrje mund ta bëni, por nuk besoj se kemi interes të shpenzojmë kohë për çështjet e teknikës legislative, se nuk është *domain-i* i diskutimit të sotëm, as për teknikalitete të çdo lloji forme që të jetë. Në rast se ka qasje të karakterit parimor për një apo dy çështje mund ta merrni fjalën me kënaqësi.

Urdhëroni, prezantohuni, ju lutem!

Iris Aliaj – Përshëndetje të gjithëve. Unë quhem Iris Aliaj dhe jam avokate pranë Qendrës për Nismën Ligjore Qytetare, një nga organizatat pjesë të Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

Edhe unë doja të bëja një saktësim për fjalën që tha zonja Xhafa, se disa organizata, që kanë dhënë kontribute, nuk janë këtu. Pjesë e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore janë disa organizata që janë prezente, pjesa tjetër janë organizata të tjera, si refleksione apo linja e këshillimit për burra dhe gra, strehëza, pra janë 45 organizata, të cilat kanë kontribute për sa i përket dhunës me bazë gjinore dhe punojnë përditë me çështjet e dhunës me bazë gjinore, si në ofrimin e shërbimit ligjor falas dhe shërbimeve të tjera psikologjike apo mbështetëse për viktimën.

Në fakt, unë do të doja të bëja disa propozime të tjera që i kemi paraqitur me shkrim pranë komisionit tuaj, por mendoj se është e rëndësishme t'i ndaj me ju sot.

Ne kemi propozuar që në nenin 2, pika 2 e projektit të ndryshohet togfjalëshi “autori i veprës penale”. Mendojmë se kjo është e rëndësishme pasi ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është një ligj administrativo-civil, kështu që përdorimi i këtij termi nuk mendojmë se është me vend, pasi autori i veprës penale nuk është domosdoshmërisht edhe dhunues, prandaj ky term është i pasaktë dhe do të kufizonte thelbësisht fushën e zbatimit të ligjit. Në nenin 2 kemi bërë një propozim tjetër në pikën 2/e ku në fjalinë “persona që janë në lidhje afektive në çift, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje” mendojmë që të hiqet fjala “afektive” pasi kjo mund të sjellë kufizime të mbrojtjes si rezultat i interpretimeve të ndryshme që mund të bëhen nga gjykata.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zonja Xhafaj, të mbaroj dhe nëse keni komente mund t'i bisedojmë të gjithë bashkë. Unë po prezantoj propozimet e rrjetit.

Në nenin 6, pika 3 propozojmë që pas germës “c” të shtohet germa “ç”, e cila parashikon pajisjen e viktimës me ekspertizën mjekoligjore dhe raportin mjekësor përkatës, pavarësisht nëse ajo e ka denoncuar dhunën, ose e ka denoncuar atë vetëm në njërin prej proceseve gjyqësore civile apo penale. Ky parashikim kërkohet me qëllim që të rritet përgjegjshmëria dhe infrastruktura e institucioneve tona, për të mbushur detyrimet që burojnë nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Konkretisht, ne i jemi referuar Konventës së Stambollit “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” ku është parashikuar shprehimisht se sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori të veprës penale. Është neni 18, pika 4 e konventës.

Gjithashtu kemi propozuar që të bëhen ndryshime në pikën 6 të nenit 6. Pas germës “ç” të shtohet një pikë tjetër si vijon: “Marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor nga organet vendore të vendbanimit...”

Petrit Vasili – Iris, me mirëkuptimin e komisionit, nga të gjitha propozimet që ne i kemi disponuar dhe i kemi përpara, a mund të nënvijëzosh si thelbësore një apo dy, sepse të gjitha kanë vend për t'u parë dhe ata që do të merren me ripunimin sigurisht që do ta bëjnë. Le të qëndrojmë në dy apo tri momente, sepse i kemi përpara dhe nuk kemi arsye t'i marrin një për një, për më tepër që unë dhe secili nga kolegët i ndjekim hap pas hapi.

Iris Aliaj – Në rregull, po mbaroj këtë koment, pastaj do të bëj edhe një koment tjetër. Ne mendojmë se kjo dispozitë është e rëndësishme për rritjen e efektivitetit të vendimit gjyqësor,

duke iu referuar organeve vendore kompetente nga pikëpamja territoriale ku viktimat ka vendbanimin ose vendqëndrimin e saj. Në këtë mënyrë ne do të zgjidhim paqartësitë që kemi vënë re nga zbatimit i ligjit deri tani në praktikë, pasi kanë ndodhur përplasje dhe ngatërresa për sa i përket kompetencës së organit vendor, i cili ka detyrimin të zbatojë vendimin gjyqësor, kur vendbanimi ose vendqëndrimi i viktimës apo i dhunuesit kanë qenë të ndryshëm ose kur urdhri i mbrojtjes është dhënë nga një gjykatë tjetër, e cila është e ndryshme nga gjykata, në të cilën dhunuesi apo viktimat kanë vendbanimin apo vendqëndrimin e tyre.

Ne mendojmë se kjo dispozitë është e rëndësishme, pasi lidhet edhe me sigurinë e viktimës dhe marrjen e përgjegjësisë nga organet kompetente. Për sa i përket një propozimi tjetër të nenit 8 ne propozojmë që paragrafi “dh”, i shtuar në këtë projekt të riformulohet, pra të shtohet psikologu dhe/ose punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së qeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, e cila përgatit një raport për shëndetin mendor dhe gjendjen psikosociale të viktimës dhe rekomandon masat e nevojshme për të minimizuar pasojat e dhunës.

Ashtu siç është projektpropozimi mendojmë së punonjësit socialë nuk ka aftësi profesionale për të vlerësuar shëndetin mendor të viktimës.

Faleminderit shumë për vëmendjen dhe për mundësinë që na dhatë për të shprehur mendimet tona në këtë komision të rëndësishëm!

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit shumë për komentet dhe për amendimet e detajuara, që ju propozoni! A ka ndonjë koment tjetër?

Pashë që patët një shkëmbim lidhur me përcaktimin e termit “afektive”.

Altin Hazizaj – Nëse më lejoni bindja jonë është që pa diskutim që marrëdhënia afektive duhet të jetë, sepse përfshin një marrëdhënie, që, në atë fushë, është pak gri, që do të thotë jo detyrimisht një marrëdhënie bashkëjetuese, por një marrëdhënie ku ke një të dashur, se nuk dua të përdor fjalë që në shqip kanë një konotacion negativ, si për shembull “dashnor” apo “dashnore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë shqip, por konotacionin e kanë të ngarkuar.

Petrit Vasili – Të bëj një pyetje konkrete, se këtu jemi në një vend kur kemi marrë përsipër të bëjmë ligje. A na qëndrojnë këta terma që janë shumë evaziv? Si do ta zgjidhim këtë termin “afektive”?

Altin Hazizaj – Ka shumë, si në ekspertizën e shteteve anëtare të BE-së, edhe në nivel ndërkombëtar marrëdhënia afektive...

Petrit Vasili – Ata që janë çifte dhe afeksioni i tyre ka mbaruar, apo ata që konsiderohen apriori se janë afeksionuar?

Altin Hazizaj – Marrëdhënie afektive do të thotë që ka një lidhje.

Petrit Vasili – Ne duhet të sanksionojmë një marrëdhënie ku njerëzit bashkëndajnë punët dhe përgjegjësitë e tyre, por çështja afektive apo jo afektive më vjen keq....kjo nuk është legjislacion, por romantizëm.

Altin Hazizaj – Ligjërisht ka dy momente kryesore: Kodi i Familjes, i cili rregullon marrëdhënien familjare, njeh dy momente kryesore: familjen ndërmjet një burri dhe një gruaje dhe bashkëjetesën mes tyre. Po marr dy adoleshentë që janë të dhunshëm ndaj njëri-tjetrit, mund të jetë vajza ose djali, nuk bashkëtojnë, nuk kanë krijuar familje, se nuk kanë mbushur moshën e lidhjes së familjes, që është 18 vjeç, mosha minimale në Shqipëri, automatikisht ligji nuk i mbron dot. Marrim, për shembull, persona që i përkasin komunitetit të LGBTI-së. Këta janë në një marrëdhënie afektive, por ligji nuk ua njeh atyre të drejtën të bashkëtojnë, jo se ata nuk bashkëtojnë dot.

Petrit Vasili – Cila është pengesa për të bashkëjetuar?

Altin Hazizaj – Pengesa ligjore është që ligji nuk ua njeh jo se ka pengesë ligjore, që do të thotë se ke një fushë gri e cila nuk mbulohet nga Kodi i Familjes, por në jetën reale njerëzit krijojnë marrëdhënie që jo detyrimisht janë bashkëjetesë apo familje.

Petrit Vasili – A e dini se çfarë dua të them unë, që të jem fare i qartë?

Neve na duhen koncepte të konsoliduara, ne kemi për detyrë të ligjërojmë një status të tillë që kur dhuna ushtrohet ndaj saj të reagohet në mënyrë të menjëhershme dhe të fortë. Lindin në mënyrë afektive apo këta njerëz nuk e duan fare njëri-tjetrin, por rrinë bashkë se u interesojnë paratë dhe në një moment të caktuar ky vokacion mbaron se njëri u batërdis dhe nuk i ka më lekët, apo se tjetri humb interesin, dhuna kudo që të shfaqet dhe cilido qoftë motivi duhet përcaktuar. Kurse çështjen afektive apo joafektive ne nuk e zgjidhim dot, sepse, siç thatë ju, mund të kemi dy të rinj që nuk janë në moshën e duhur, njëri ka merak tjetrit, ose njëri është refuzues dhe tjetri këmbëngulës, ose nuk ndjen asgjë. Çfarë emri do t'i vënë kësaj ne?

Një marrëdhënie ku njeri nuk i përgjigjet tjetrit? Prandaj koncepti duhet të jetë kurdo dhe shumë i thjeshtë për dhunën, në çdo lloj forme që të shfaqet, edhe brenda ambienteve të bashkëndara, se kur bëhet fjalë për bashkëjetesë, apo çdo lloj forme tjetër, ata bashkëndajnë, në kuptimin tradicional, një kulm apo një ambient të përbashkët ku disa përgjegjësi i zhvillojnë bashkë dhe një moment të caktuar do t'i thonë njëri-tjetrit “Ne kemi qenë të afektuar, por nuk jemi më”, kështu që kudo që të shfaqet dhuna duhet specifikuar. Ky përcaktim asgjë nuk i thotë kësaj gjëje në kuptimin praktik të fjalës, shton një element romantizmi. Institucionet të e së

drejtës, si gjykatat, apo skuadrat e ekzekutivit që ndërhyjnë në këtë punë, përcaktojnë që askush të mos ketë të drejtë të dhunojë tjetrin. Është me e dhimbshme kur janë bashkë. Marrëdhënie afektive quhet nëse rrinë bashkë në një shtëpi, se nuk paskan ku të jetojnë, se do të rrihet kunati me kunatën?

Sa më konkretë të jemi në këto gjëra aq më mirë është.

Altin Hazizaj – Marrëdhënien afektive nuk duhet ta marrim thjesht në sensin e marrëdhënies dashurore, sepse shpesh ajo mund të përkthehet në lindje të fëmijëve (jo detyrimisht ata bashkëjetojnë), mund të kthehet në dhunë seksuale ndaj njëri-tjetrit. Pra, çështja është a duam që t'i mbrojmë të gjithë personat ligjërisht, që janë në një marrëdhënie të caktuar, e cila termin e përgjithshëm të familjes quhet një marrëdhënie afektive, apo do të vendosim që në rastin "a" do t'i referohemi Kodit Penal dhe personi mund të kërkojë mbrojtje? Problemi është se persona të tillë, të cilët, në bazë të Kodit mund të përfitojnë mbrojtje, pra të denoncojnë raste të tilla, nuk do të përfitojnë nga shërbimet, pasi duhet të paguajnë për këto shërbime, sepse koncepti i ofrimit të shërbimeve bëhet për disa kategori të caktuara. Pra, çështja është a duhet të jemi gjithëpërfshirës dhe të mbrojmë të gjitha llojet e marrëdhënieve njerëzore që krijohen me të drejtë, qoftë dhe marrëdhënie afektive, apo duhet të kemi atë konceptin e ngushtë që të jetë një marrëdhënie që ndodh?

Petrit Vasili – Më fal, por nuk e kemi atë konceptin e ngushtë.

Altin Hazizaj – Koncepti i ngushtë është ajo që ndodh brenda kulmit, kurse koncepti i gjerë është ndodh në marrëdhënie njerëzore. Kjo është diferenca.

Petrit Vasili – Ky është një përcaktim ligjor, çdo fjalë e shkruar në ligj ka një kuptim të caktuar. Nuk e keni merakun që një fjalë e tillë e papërcaktuar nuk ndihmon? Nuk na ka ndihmuar ne në të gjithë legjislacionin. Ja, kemi plot gjëra edhe në reformën në drejtësi ku ka përcaktime të gjera evazive, të cilat nuk na kanë ndihmuar madje e kanë penguar procesin. Këtë gjë e kam pasur merak edhe atëherë dhe kërkoja që të hiqeshin përcaktimet e gjërat evazive, apo që kanë elemente të subjektivizmit apo të sensibiliteteve. Nuk ka ligji sensibilitete, ligji ka përcaktime shumë të ftohta ligjore. Por për çfarë arsye? Ne prandaj kemi ardhur, që të përmirësojmë këtë ligj, edhe sikur të mos e përmirësojmë dhe t'i përdorim ftohtë të gjitha instrumentet, mund ta bëjmë. Ne po e rimarrim në një optikë të re dhe meqenëse Konventa e Stambollit ka krijuar disa premisa plus, po i reflekojmë këtu.

Merita Xhafaj – Para disa ditësh na ndodhi rasti i Durrësit, ka pasur dy denoncime në polici para se të ndodhte krimi. Njëri denoncim është bërë nga vajza dhe një tjetër është bërë nga djali. Denoncimi i djalit thoshte se denoncimi i vajzës ka qenë mashtrim, sepse ajo ka abuzuar duke përvetësuar 2000 euro, nuk ka rëndësi ta themi këtu se është çështje e denoncimit në polici,

por ne e kemi ndjekur rastin dhe realisht nuk është marrë dot masë, nuk ka dalë dot urdhri i mbrojtjes dhe përfunduar në një krim pikërisht se këtu nuk ishte e parashikuar marrëdhënia afektive ndërmjet tyre. Nuk ka vetëm marrëdhënie afektive, por ka edhe marrëdhënie infantile, të cilat ne i kemi trajtuar në të gjitha diskutimet dhe konsultimet që kemi bërë me ekspertët vendas më të mirë të fushës dhe të huaj, në këndvështrimin e zbatimit të rekomandimeve të Konventës së Stambollit. Kam pasur rastin ta drejtoj vetë atë raportim dhe e di në detaje, prandaj, nëse ne nuk e kuptojmë akoma se çfarë pasojash sjell një marrëdhënie afektive....

Petrit Vasili – Ne nuk mund ta kuptojmë se nuk jemi të gjithë mendjehapur si ju. Unë nuk e kam për turp të jem mendjembyllur. Unë kam këtë pyetje, meqë ma dhe këtë rrethanë. Kush i pengoi ata kur kishin denoncim? Policia e Shtetit dhe gjykata le ta vlerësonin masën. Mos vallë i pengoi ky përcaktim ligjor? Jo, ata nuk kanë dashur të bëjnë detyrën.

Merita Xhafaj – Natyrisht që i pengon.

Petrit Vasili – E keni gabim, zonja Xhafa, nuk kanë dashur të bëjnë detyrën. A do t'ju jap një kundër rast? Rasti i asaj gjykatëses, që, paste rahmet, u vra me dhjetë denoncime dhe vdiq. A ishin burrë e grua ata? A e sheh pra sa i qartë është ligji?! Problemi është një gjë: vullneti për të zbatuar ligjet është një gjë dhe këto që kemi t'i miratojmë të gjitha, problemi është çështje vullneti. Këto mund të mbeten gjëra në letër. Ai rasti që ju e referuat, a pati një denoncim, pati dhe një denoncim të dytë, atëherë ky nuk është një shqetësim që të ketë një marrëveshje konfliktuale, këtë nuk e zgjidh ligji. Ky problem është se sa seriozisht do t'i marrësh gjërat.

Elisa Spiropali – Po ishin denoncime të kundërta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Merita Xhafaj – Ato janë të mbrojtura dhe polici nuk merr dot masë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Si nuk të thotë gjë, kur unë jam i kërcënuar dhe i kërcënuari nuk mund të mbrohet? Lërimi këto që thoni.

Merita Xhafaj – Marrëdhënia afektive, jo vetëm që shoqërohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Po Kodi Penal një përcaktim i vogël është?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dhe e zgjidh fjala “afektive”?

Merita Xhafaj – Marrëdhënia afektive jo vetëm që shoqërohet dhe ka pasoja të tilla, por, nga ana tjetër, duhet të kemi në konsideratë që një marrëdhënie afektive mund të ketë edhe me një fëmijë, që e sjell njëri nga dy partnerët brenda në shtëpi dhe është viktimë e dhunës. Në të

gjitha këto raste ndryshimet janë propozuar duke u parë jo vetëm nga rekomandimet, por edhe nga praktikat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rastet konkrete.

Elisa Spiropali – A keni praktika ligjore konkrete të vendeve të tjera, ku parashikohet, me këta terma, marrëdhënia afektive?

Merita Xhafaj – Kemi praktikën e Austrisë, e cila ka ligjin dhe strukturat më të mira, pra është një vend model. Në kontekstin e raportit përfundimtar për zbatimin e Konventës së Stambollit, vendi ynë ka dalë pak a shumë njëlloj, sepse ka pasur goxha progres në zbatimin e detyrimeve të konventës. Të dyja shtetet kemi qenë ndër vendet e para që jemi monitoruar. Por raporti nuk është i muajit dhjetor. Në muajin nëntor ne kemi dërguar komentet tona që i janë bashkangjitur raportit. Nga ana tjetër, nëpërmjet UNDP-së ka filluar, (natyrisht, dihet që një nga donatorët më të mëdhenj të çështjeve të dhunës në Shqipëri është SIDA suedeze) edhe një *Webimar* me Korenë, për trajtimin e qendrave të emergjencës së dhunës. Raste të tilla të trajtimit dhe të lidhjeve afektive ka në Kore dhe në Austri. Pra, në të dyja modelet gjendet lidhja afektive.

Petrit Vasili – Nga njëra anë e globit në anën tjetër. Po këtu në Ballkan a kemi ndonjë praktikë?

Merita Xhafaj – Nga njëra anë e globit në anën tjetër, sepse Konventa e Stambollit, pavarësisht se është një konventë e Këshillit të Europës, nuk është një konventë e mirëfilltë ndërkombëtare e OKB-së, por për shkak të një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, me Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkimit Europian, është konsideruar si standard për trajtimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, konkretisht të dhunës me bazë gjinore dhe është trajtuar në standardet që merren në konsideratë në raportprogres për Shqipërinë edhe nga Bashkimi Europian.

Petrit Vasili – Kjo shkon edhe më tej se dhuna ndaj barazisë gjinore.

Merita Xhafaj – Kjo përmbledh dhunën në marrëdhëniet familjare.

Petrit Vasili – Prandaj nuk kemi përse t'i referohemi, sepse kemi dy lloje konceptesh.

Merita Xhafaj – Kjo përmbledh edhe personat me aftësi të kufizuar brenda familjes dhe është pjesë e konventës.

Petrit Vasili – Dakord, por sot kemi objekt tjetër.

Fjalën e ka zonja Bode.

Edlira Bode – Më falni, e marrim të mirëqenë faktin që e kemi të qartë përkufizimin e marrëdhënies afektive, kush më mirë dhe kush më keq, por nisemi nga presupozimi që e dimë se

si është përkufizuar, në momentin e një rasti dhune kush e përcakton, ishin apo nuk ishin, janë apo nuk janë në një marrëdhënie afektive personat e përfshirë?

Altin Hazizaj – Ka shumë momente që ligji ua lë në dorë personave që preken nga dhuna për të përcaktuar ose për të shprehur marrëdhënien.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prokuroria dhe gjykata i kanë mjetet e domosdoshme për t'i vërtetuar, sepse do të duhet të ndërtojnë pyetje si prokurori, ashtu edhe avokati.

Elisa Spiropali – Doja të flisja për procedurë, sepse ky nuk është një diskutim nen për nen, ku ne mund të hyjmë në detaje të ligjit, të teknikave, fjalëve dhe me radhë, besoj se do të kemi një rast tjetër për këtë. Ky është një takim për të dëgjuar të gjitha propozimet që keni, dhe jam e sigurt që kryetari, në emër të komisionit, do t'i përcjellë edhe te komisioni përgjegjës. Personalisht më duket që shoqëria civile ka pasur një rol jo vetëm pozitiv, por edhe shumë produktiv për këtë ligj. Uroj që të kalojë i plotë dhe të kemi më në fund një ligj i cili prek praktikën më të mira. Me atë që dëgjova nga zonja Xhafaj, për praktikën që janë parë, Austria është një vend që dallon nga të tjerët për sa i takon dhunës në familje me bazë gjinore dhe me radhë, por do të ishte mirë t'i diskutonim në të tjera takime. Duke parë që edhe kohën e kemi të kufizuar, ndoshta as ju dhe as deputetët mos hyni në detaje, sepse do të kemi raste të tjera për të diskutuar projektligjin nen për nen.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit!

Nga ana procedurale, zonja Spiropali, mundësia e vetme që grupet e interesit të flasin edhe për ndryshimet përkatëse, që afektojnë nenet përkatëse, është vetëm kjo. Më tutje procedura përmban, thjesht dhe vetëm, diskutimin e komisionit, i cili do ta miratojë nen për nen dhe në tërësi, prandaj është e paevitueshme që për çështje të caktuara të diskutohet. Këtu debati është normal, janë propozuar me dhjetëra korrigjime dhe përmirësime ku nuk po qëndrohet, por kur ka çështje që kanë të bëjnë me elemente konceptuale është momenti për t'i diskutuar me shoqërinë civile, sepse ne nuk kemi kur t'i diskutojmë.

Çështja ku qëndruam më gjatë ishte një raport, i cili e bënte ligjin konkret apo evaziv, e bën të verifikueshëm dhe të zbatueshëm apo nuk e bën. Po të marrim diskutimet, të listuara nga unë janë minimumi mbi 50 korrigjime, në të cilët ne nuk jemi ndalur. Unë besoj që edhe ky debat na bën mirë, pasi nuk do të takohemi më për këtë projektligj .

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ishte një diskutim që nuk kishte asgjë të keqe dhe ishte shumë mirë që u diskutua, sepse ishte një pike e vetme

Elisa Spiropali – Nuk ka nevojë për këtë debat, sepse nuk thashë që ka ndonjë gjë të keqe, përkundrazi unë thashë që debati është shumë i vlefshëm, pastaj për detajet e kuptimeve dhe fjalëve të ligjit besoj se ne i kemi të gjitha propozimet.

Petrit Vasili – Ky ishte një debat i cili u hap këtu, shumë thjesht, për të qartësuar, pasi kishte evazivitete dhe kishte të bënte me thelbin e një marrëdhënie. Këtu është sjell një ligj për dhunën në marrëdhënien familjare dhe çështja e afeksionit është një nyje lidhëse për qasjen e ligjit, prandaj ishte një diskutim konceptual, nuk kishte të bënte fare me detaje. Detajet e bëra këtu kanë qenë pa fund.

Elisa Spiropali – Meqë ra fjala për pjesën e afeksionit, mendoj që ekspertët e kanë ditur më mirë kur e kanë hartuar, si në këshill kur e keni diskutuar, si ekspertët e ministrisë, si ata që janë teknikienë dhe si ata që kanë parë praktikën, sepse çështja e marrëdhënieve afektive njihet kudo. Personalisht kam punuar në një firmë ligjore në New York që merrej me çështjet Foster Cary Forms, Sivil Rights e të tjera dhe marrëdhëniet është kudo, sepse ekziston dhe nuk mund të mos e parashikosh në ligj, ndryshe ai polici thotë: nuk e kam fare dhe nuk parashikohet, ndryshe ekspertët që duhet të kujdesen për shërbimet që duhet të marrin, thonë kjo nuk parashikohet, nuk është as familje dhe as bashkëjetesë. Ndërkohë ai mund të jetë një njeri në moshë minore që keqtrajtohet nga partneri, prandaj duhet patjetër të parashikohet, sipas mendimit tim, pastaj diskutimet bëhen edhe me ekspertët përkatës.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit!

Edhe një herë tjetër këtë debat e hapëm, sepse jo të gjithë ishim në një mendje dhe përderisa nuk ishim në një mendje, kishte vend për debat, po të ishim në një mendje, nuk do të kishte nevojë për debat. Edhe një nga përfaqësuesit e shoqërisë civile e ka paraqitur si çështje, ka edhe një çështje tjetër, por ne nuk po qëndrojmë rastësisht në këtë punë. Ne e kemi shumë të lehtë të konformohemi me çdo gjë dhe shumë lehtë themi që bëhet kështu, vendoset këtu dhe bëhet kështu. Jo rastësisht pyeta se cilat janë praktikën në vendet e Ballkanit. Ndonjëri prej jush do të më thotë që ne kemi një profil social, historik dhe etnologjik të njëjtë me atë austriak, pra dikush mund të thotë që jemi të ngjashëm, unë nuk them që nuk jemi të ngjashëm, por në mjaft vende fqinje me ne, që ndajnë ngjashmëri shumë më të forta, kur kanë rezerva, neve na intereson të themi po këta të tjerët përse nuk shtyhen kaq shumë. Cili është meraku? Meraku është shumë i thjeshtë, për të bërë ligje realiste që të mos mbeten në letër. Kemi histori të ligjeve të mbetura në letër, shumë të pasur dhe shumë të mirë. Na kanë thënë të gjithë që në shumicën e rasteve keni ligjet më të mira në botë, por keni zbatueshmërinë më të keqe në botë. Kjo na bën ne që të rrimë në këto lloj përcaktimesh. Veç të tjerave ne kemi momente të caktuara, për profilin që

kemi, meqë jemi më sanguinë dhe më emotiv, edhe mënyrën se si hakmerremi e kemi pak më veçantë, më të egër, nganjëherë edhe më të pamëshirshme. Kjo marrëdhënie e përcaktuar afektive, në momentin që dikush do të hakmerret, përdor një term të tillë, i cili është evaziv, pasi edhe Altini e tha qartë që njerëzit deklarohen si të tillë, për këtë do të merren organe përkatëse që ta provojnë. Por a ka ndonjë organ që mund të provojë një marrëdhënie subjektive? Termi “afektiv” është subjektiv. Nuk ka prokuror në botë që të thotë: ti je në një marrëdhënie afektive, sepse do të marrë një marrëdhënie mekanike, sepse ju kemi hyrë dhe keni dalë në një banesë, keni bërë këtë dhe këtë, por të gjitha këto nuk i dimë. Tani afektive do të thotë të lexosh zemrat dhe zemrat nuk i lexon dot as prokuroria, as Kodi Penal dhe as Kodi Civil. Këtu ka goxha evazivitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka njerëz që janë më të prapambetur dhe unë bëj pjesë tek ata, nuk ka ndonjë të keqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumica e opinionit ecën përpara dhe do të fitojë kjo që po diskutoni, por besoj se debati nuk ka përse të na shqetësojë, sepse është interesant si i tillë. Në mënyrë që të mos ndodhemi në marrëdhënie të tilla, kur tjetri të jetë duke pretenduar që ka pasur marrëdhënie afektive, do që të nxjerrë një inat shumë të egër ndaj filanit dhe gjëra të tjera, këto gjëra janë që e përditshmja i provon. Këtu në tavolinë janë në rregull, po në realitetin e përditshëm në sallat e gjyqeve jo vetëm që i provon, por mbi to ndërtohen ca hakmarrje edhe më të egra, nga të cilat ndodhin disa krime, që ne me shumë të drejtë mërzhitemi dhe themi: si ndodhi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Spiropali ta mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, kemi opinione të ndara.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë verifikuar dhe mbas verifikimeve kanë ndodhur edhe krime.

Po mund ta merrni fjalën.

Irena Shtraza – Dua të sugjeroj lidhur me këtë temë, për të cilën u bë edhe debati, ministria që ka sugjeruar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të sjellë edhe një rationale të shkruar, sepse si ju, zoti kryetar, dhe shumë të tjerë këtu nuk janë të bindur...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të sillen një racionalë ku të thuhet se ku e keni mbështetur propozimin, në mënyrë që të binden edhe të tjerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë të citohen praktika të tjera ndërkombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk po më kuptoni, zonja Merita, nuk po them që ta hiqni, por thjesht ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Deri kur keni kohë të sillni ndonjë koment tjetër që mund të na vijë nga organizatat tona në terren, që nuk kanë pasur mundësi t'i sjellin?

Petrit Vasili – Duhet të sillen brenda ditës së sotme, sepse do të bëjmë relacionin dhe pengojmë punën e komisionit tjetër.

Fjalën e ka zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë përfitoj nga rasti të falënderoj të gjithë përfaqësuesit e institucioneve për kontributin dhe për shërbimet që kanë ofruar ndër vite, por edhe për angazhimin e tyre në përmirësimin projektligjit. E thashë edhe dje në mbledhje që projektligji është pak i vonuar dhe duhet të vinte pak më shpejt, për shkak të nevojave, domosdoshmërisë për ta ndryshuar dhe për shkak të problematikave që janë hasur ndër këto vite. Në formën që ka ardhur është më i përmirësuar, shumë më efikas dhe mezi pres që të hyjë në fuqi, që të merren ato masa që janë shkruar në letër.

Për sa u përket kontributeve, edhe unë mbështes atë që tha zonja Merita, për një projektligj të veçantë për të adresuar të gjitha format e dhunës ndaj gruas. Të gjitha raportet ndërkombëtare, që janë bërë për Shqipërinë, na kanë sugjeruar këtë dhe them që patjetër duhet një ligj i veçantë për të adresuar të gjithë format e dhunës ndaj gruas.

Ndërkohë që për sa u përket angazhimeve dhe kontributit të ekspertëve, përveç grupit të punës së ministrisë, duke respektuar në maksimum ekspertet që kanë punuar dhe kontribuar për ligjin edhe për hir të përvojës dhe ekspertizës së tyre, jam e sigurt që edhe për konceptin afektiv do të ketë një përkufizim të veçantë në projektligj, për të na qartësuar të gjithëve dhe për ta bërë më të saktë këtë gjë, pra se ku është bazuar dhe cili është përkufizimi për të mos e lënë evazive. Por nga përvoja e mëparshme dhe nga rastet që janë hasur ka pasur boshllëk në ligj për ta adresuar këtë lloj forme të dhunës nga institucionet. Prandaj të gjitha ndryshimet e sjella, mendoj që janë shumë të domosdoshme dhe të bazuara në përvojat konkrete. Më vjen keq që nga i gjithë ky proces kaq i hapur, me kaq pjesëmarrës dhe diskutime, në disa debate kam qenë bashkë me shoqërinë civile, serish nuk janë ezauruar të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja. Ju keni akoma

materiale të shoqatave që nuk kanë arritur t'i bëjnë, ndërkohë që procesi ka qenë shumë i hapur, si nga pjesa e grupit të punës, por edhe nga pjesa e diskutimeve, ashtu edhe fakti që ka qenë *online* dhe janë pritur sugjerime, mund ta kishim mbyllur dhe përfunduar së bashku që të hyjë sa më shpejt në fuqi. Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Gjermani!

A ka ndonjë koment tjetër nga të ftuarit?

A ka nga kolegët?

Meqenëse nuk ka komente, ju falënderoj të gjithëve!

Rikonfirmoj edhe një herë që komentet e detajuara, pa diskutim në formatet tona parlamentare do të përcillen si të gjitha opsionet dhe alternativat për t'u marrë parasysh. Në diskutimin që do të kemi nën për nën, është një tjetër mundësi që ne të pranojmë disa prej tyre, sa është e mundur, por sigurisht që fjalën përfundimtare do ta thotë seanca, nuk mund ta themi ne. Një moment tjetër i rëndësishëm do të jetë edhe shqyrtimi në komisionin përgjegjës, pasi janë dy etapa ku ka mundësi reflektimi. Nuk e kemi këtë mundësi që të vendosim, mbase duke pasur dakordësi, pasi shumë këtu kanë qenë aktorë të drejtpërdrejtë në proces, ta zgjidhnim që këtu, pra të pranim dhe të reflektonim për ato që ishin të domosdoshme, megjithëse nuk kemi çfarë të bëjmë. Do të bëjmë më të mirën duke insistuar fort edhe në Komisionin e Çështjeve Ligjore, se besoj që edhe atje do të ketë ndjeshmëri të lartë ndaj një problematike kaq delikate.

Do të jemi në kontakt edhe për nismën që kemi diskutuar në dëgjuesën e shkuar, e cila, sigurisht, na vë një krizë kohe, por mund të shfrytëzojmë vjeshtën për këtë gjë, pasi edhe axhenda është shumë e ngarkuar. Megjithatë edhe atëherë në kohë jemi. Ne do të vazhdojmë ta ruajmë një kontakt të tillë, sepse na ka bërë më mirë dhe jemi shumë më familjarë për sa i përket çështjeve të caktuara. Në këtë komunikim evitojmë çdo lloj hendeku, pasi është një komunikim i natyrshëm dhe jo i sforcuar. Siç tha edhe kolegja, mund të na dërgoni edhe ndonjë koment të fundit, por duhet të nxitoni pasi stafi nuk ka mundësi dhe kohë pa fund në dispozicion që të reflektojë.

Ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen tuaj!

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA